

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Ditari i Qosjes: Çka shkruante akademiku pas arrestimit të Thaçit dhe të tjerëve
ADRESA	https://www.koha.net/arberi/ditari-i-qosjes-cka-shkruante-akademiku-pas-arrestimit-te-th-acit-dhe-te-tjerve
BURIMI	koha.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 02:42:52 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 20:08:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	86dcf26983c3b544394502968595f09dba1b3e4e53b20e45bb2a2930ff215541
TEKSTI	d8f8472baf04b755375dc930a2d978237b18f7063097b08b81a95c057a7b8b30
PAMJA	1ca98e2105ca0cbf463ae7e312a08e9a11bd0ac476ed1d3d62dd58b5200f5507

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	5a6fde63031ae75ca00960fab53429cea8d0149b5f17d76bbd29e11d53c480df
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	620a3e0ea5360256664d4fe0b9b06d4faf85ac171f0ef56a543d5c170249f92b
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/5a6fde63031ae75ca00960fab53429cea8d0149b5f17d76bbd29e11d53c480df>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

ARBËRI

Ditari i Qosjes: Çka shkruante akademiku pas arrestimit të Thaçit dhe të tjerëve




Foto: Maximilian Gödecke

16 shtator 2026 22:08

Shpërndaje në:



Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalin tonë zyrtar në Viber

Fragment nga ditari i akademikut Rexhep Qosja, publikuar në llogarinë e tij në Facebook e cila menaxhohet nga familjarët

Ditari i Rexhep Qosjes, 4–5 nëntor 2020

Përshkrim:

Këto faqe nga ditari i Rexhep Qosjes (ende i pabotuar), të shkruara më 4 dhe 5 nëntor 2020, regjistrojnë reagimin e tij ndaj arrestimit dhe dërgimit në Hagë të drejtuesve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe figurave politike të Kosovës. Në shënime të tij Qosja përshkruan bastisjen e shtëpisë së Jakup Krasniqit, arrestimet e Jakup Krasniqit, Rexhep Selimit, Hashim Thaçit dhe Kadri Veselit, si dhe shqetësimin e tij për krijimin dhe funksionimin e Dhomave të Specializuara të Kosovës. Më poshtë publikohet transkriptimi i faqeve, i shoqëruar me riprodhimet e skanimeve origjinale.

Faqja 66 — 4.11.2020

Uniforma të EULEX-it iu kanë turrur sot shtëpisë së ish-kryetarit të Kuvendit të Kosovës dhe historianit, Jakup Krasniqi, në Prishtinë dhe shtëpisë në fshatin e lindjes.

Bastisja e tyre në shtëpinë e Jakupit ka zgjatur prej mëngjesit, herët, e deri pasdite, mediet thonë afër nëntë orë. Au! Au! Çfarë vrazhdësie! Çfarë egërsie! Më vonë merret vesh se janë marrë edhe librat e tij që ka shkruar – për të parë çka kishte shkruar e çka kishte menduar! Stalinizëm “demokratik” evropian!

Kjo sjellje ndaj zëdhënësit të UÇK-së, sipas të gjitha gjasave, është parathënie e sjelljes që do të pasojë ndaj kryetarit të Kosovës, Hashim Thaçit, i akuzuar prej “Dhomave të Posaçme të Kosovës” në Hagë.

Në mbrëmje merret vesh se Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi, shefi i Grupit të deputetëve të (Lëvizjes Vetëvendosje) Kuvendit të

Arbëri.

81 vjet burgim për katër ish-drejtuesit e UÇK-së

Arbëri.

Qytetarët sërish mbledhen para EULEX-it, e gjuajnë me gurë e mjete piroteknike

Arbëri.

Dy protestues u shoqëruan në polici, njëri u ndalua për 48 orë

Kronikë.

Vdiq një 21-vjeçar, u godit nga vetura në fshatin Vlashnje

Futboll.

Humbje për Milanin në Ligën e Evropës

Futboll.

Tjetër goditje për Manchester Unitedin

Kosovës janë çuar në Hagë! Mediet tona thonë çfigurshëm :
udhëtuan për në Hagë!
Jam shumë i brengosur. Keqardhje e madhe më ka pushtuar. Po
përrjetojmë ditë të vështira!
Kosova institucionalisht nuk është e aftë, nuk është e përgatitur
për të mbrojtuar askë e asgjë.

Edhe



Arbëri • 6 o. më parë

Familjarët e Thaçit, Krasniqit e Veselit
besojnë në luftën e pastër të UÇK-së

Faqja 67 — 5.11.2020

Forcat në uniforma të EULEX-it sot kanë marrë Kryetarin e Kosovës, Hashim Thaçinin, dhe kryetarin e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veselin. Shihen xhipat e Euleksit të përcjellë prej xhipave të policisë së Kosovës duke i çuar në aeroport!

Para se të merrej prej Euleksit Hashim Thaçi ka dhënë dorëheqje nga pozita e kryetarit të Kosovës — mbasi është bërë publik vendimi i Dhomave të Posaçme të Kosovës në Hagë se aktakuza ndaj tij është konfirmuar!

Dorëheqje prej detyrës së kryetarit të PDK-së ka dhënë, Kadri Veseli. Ai thekson se ka dhënë dorëheqje edhe prej të gjitha detyrave të tjera zyrtare që kishte.

Këto janë aktakuzat e konfirmuara më tronditëse, që e rëndojnë shumë UÇK-në, që e rëndojnë edhe Kosovën shtet, që na rëndojnë shumë të gjithëve.

Njëzet vjet pas luftës ne përndiqemi penalisht e "juridikisht" prej Gjykatës së Posaçme që krijuam vetë.

E krijuam atë Gjykatë ata që tani do të gjykohen prej saj!

Isha kundër krijimit të asaj Gjykate me shkrime e me intervista.

E theksoja: ne nuk mund të pengojmë OKB-në, SHBA-në dhe BE-në të krijojnë atë Gjykatë, por ne vetë, kurrsesi nuk duhet ta krijojmë. Nuk duhet të pranojmë që të dënojmë vetëveten. Lufta jonë ishte luftë mbrojtëse, luftë çlirimtare, luftë për të mbrojtur jetën tonë, shtëpitë tona, tokën tonë, ekzistencën tonë nga pushtimi, eksploatimi, shtypja e Serbisë. Luftërat mbrojtëse, çlirimtare kurrë, gjatë historisë nuk janë nxjerrë para gjykatësve, nuk janë dënuar në Evropë. Qe, po duan të na dënojnë tani ne! Çudi e madhe është kjo. E kjo çudi do të jetë e tmerrshme po të marrim pjesë edhe ne, vetë, në krijimin e saj – për të dënuar vetëveten! Jo! Jo! Jo!

Por Hashim Thaçi ishte këmbëngulës për ta krijuar ne, vetë, këtë Gjykatë të posaçme!

Më vonë u muar vesh se Hashim Thaçi, Kadri Vesli e Rexhep Selimi janë çuar me aeroplan ushtarak në Hagë!

O, o, o sa jam i tronditur! Dje Jakupi, Jakup Krasniqi, e sot këta te tre! Hashimi, Kadriu, Rexhepi!

Çka do Evropa? Çka do të arrijë me këto Gjykime të Gjykatës së Posaçme? Ta barazojë luftën tonë mbrojtëse me luftën pushtuese të Serbisë?!

KOSOVË! KOSOVË! ÇKA PRITE!



Thaçi e Krasniqi dënohen me nga 25 vjet burgim, Veseli 18 e Selimi 13

Gjykata Speciale ka dënuar me nga 25 vjet burgim Hashim Thaçin e Jakup Krasniqin, me 18...

#REXHEP QOSJA

#GJYKATA SPECIALE

#ISH-KRERËT E UÇK-SË

Artikuj të ngjashëm

LAJMET E MBRËMJES • 6 o. më parë

Avokati i Thaçit sugjeron Kuvendin t'ia heqë mbështetjen Speciales

Arbëri • 13 o. më parë

PDK: Historia e Kosovës nuk rishkruhet me një aktgjykim

Arbëri • 2 kor 2026

Procesi gati 6-vjeçar ndaj Thaçit dhe të tjerëve drejt fundit

Arbëri • 12 maj 2026

Gjykata Speciale ndan pamje nga burgu ku mbahen ish-drejtesit e UÇK-së

KOHA

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografite, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë original apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësive që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

Marketing

Politika e privatësisë

Kushtet e përdorimit

Udhëzim për përdorimin e IA-së

Cilësimet e privatësisë dhe cookies

Përkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!

+383 (0) 38 249 105 /

AL | EN | DE | FR | ES | GR | SR | TR | MK

Aneksi i ish-Radio Prishtinës (kati i parë) Xhorxh Bush p.n., 10000 Prishtinë

Shkarkoje aplikacionin e KOHËS